

ANALIZË E ARSYEVE TË HESHTJES SË ADMINISTRATËS NË PËRGGJIGJE TË KËRKESAVE PËR INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK



Botues:

Asociacioni për Iniciativa Demokratike

Autor:

D-r Risto Karajkov dhe Angelina Mickoska

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Agim Mustafai



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



Republika e Maqedonisë së Veriut



AGJENCIA E MBROJTJES TË SË
DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË
INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK

AD

Kjo analizë është përgatitur nga Asociacioni për iniciativa demokratike dhe Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike me mbështetjen e popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë analizë nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

ANALIZË

E ARSYEVE TË HESHTJES SË ADMINISTRATËS NË PËRGJIGJE TË KËRKESAVE PËR INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK

Korrik 2022

Hyrje	3
Shënim metodologjik	5
Transparencë, efikasitet, trajnim dhe bashkëpunim	7
Qëndrime të zyrtarëve për transparencën e institucionit të tyre	7
Efikasiteti i LQLIKP	8
Trajnimi i zyrtarëve	11
Njohja me parimin e delegimit të kompetencës	14
Bashkëpunimi i zyrtarit me sektorët kompetent	15
Person zyrtar i përbashkët për dy ose më shumë institucione	16
Arsyet për heshtje	18
Lloji i kërkesës	18
Vëllimi i të dhënave	19
Mosazhureteti i drejtuesve	21
Tepër obligime të personave zyrtarë	23
Tepër obligime të sektorëve kompetentë	24
Pamundësia për tu përgjigjur brenda afatit	26
Mungesa e trajnimeve	28
Prapavija e kërkesave politike	30
Shfrytëzimi i paarsyeshëm i ligjit	31
Njohuri plotësuese	33
Përgjegjësia për moszbatimin e LQLIKP-së	33
LQLIKP si zëvendësim për një rregullore tjetër	34
Konkluzion	34

1. HYRJJE

Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik (LQLIKP) u miratua për herë të parë në RMV në vitin 2006. Ligji që është aktualisht në fuqi u miratua në vitin 2019. Ai futi disa risi të rëndësishme. Me ligjin e ri, Komisioni u shndërrua në Agjenci për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik (AQLIP) ose [Agjencia](#). U shkurtuan afatet për përgjigje nga institucionet nga të cilat kërkohen të dhëna me karakter publik. Interesi publik i përcaktuar saktësisht. Në listën e poseduesve të informacioneve janë shtuar edhe partitë politike.

Agjencia ka mbl shumë kompetenca, por një nga më të rëndësishmet është të udhëheqë procedurë administrative dhe për të vendosur mbi ankesat ndaj aktvendimit me të cilin poseduesi i informacionit e ka refuzuar ose e ka hedhur poshtë kërkesën për qasje të lirë në informacion të kërkuarve.

Në vitin 2021 në agjenci janë dorëzuar 798 ankesa. Pjesa më e madhe e këtyre ankesave, gjithsej 608, janë dorëzuar nga organizatat të shoqërisë civile (OSHC).

Nga numri i përgjithshëm i ankesave, më të shumtat janë ato të paraqitura kundër institucioneve shtetërore - 458, dhe komunave - 167.

Baza për 359 (44.9%) të ankesave ka qenë ajo se institucioni nuk është përgjigjur brenda afatit ligjor (e ashtuquajtura heshtje e administratës).

Në raportin e saj vjetor për vitin 2021, Agjencia vëren se edhe përkundër faktit se shkalla e rasteve të heshtjes është e lartë (44.9%), ajo është më e ulët në krahasim me vitin 2020, që ishte 81%. Në vitin 2020, nga gjithsej 758 ankesa, 611 kanë qenë për shkak të heshtjes së administratës. Sipas të dhënave të Agjencisë, në vitet e mëparshme shkalla e ankesave shkak të heshtjes ishte rreth 75%. Kjo do të thotë se norma në vitin 2021 paraqet një rënie të ndjeshme krahasuar me trendin e viteve të mëparshme.

Për të fituar perspektivë, në vitin 2021 janë paraqitur 8910 kërkesa për QLIK. Duhet të theksohet se kjo është vetëm një shifër e përafërt. Ajo është marrë nga raportet vjetore që poseduesit ia dorëzojnë Agjencisë. Megjithatë, jo të gjithë poseduesit kanë dorëzuar raporte dhe numri i kërkesave që kanë pranuar nuk dihet për ata posedues. Nga gjithsej 1.445 posedues, 1.334 posedues kanë paraqitur raport vjetor për vitin 2021, pra 92.3%.

Nga këto 8.910 kërkesa të paraqitura në vitin 2021, 8.540 janë përgjigjur brenda afatit ligjor. Edhe pse numri nuk është i plotë sepse nuk janë dorëzuar të gjitha raportet vjetore, nga ky numër i përafërt mund të konkludohet se ligji është duke u respektuar.

Duke pasur parasysh se një pjesë e madhe e ankesave bien poshtë në bazë të heshtjes, Agjencia është e interesuar për arsyet e heshtjes së institucioneve. Ky është qëllimi specifik i kësaj analize të shkurtër. Teksti që vijon përpiket të analizojë arsyet e mundshme pse institucionet nuk u përgjigjen kërkesave për QLIK-në. Në të njëjtën kohë, teksti trajton aspekte shtesë që lidhen me zbatimin e ligjit.

Është e rëndësishme të theksohet se nuk ekziston një arsye kryesore për heshtje, as nuk ka një arsye për heshtje që vlen njëloj për të gjithë poseduesit. Ka një numër të madh poseduesish që ndahen në disa kategori kryesore. Në të njëjtën kohë, numri më i madh i kërkesave janë dorëzuar tek një numër më i vogël i kategorive të poseduesve, në radhë të parë institucionet shtetërore dhe komunat.

Konkretisht, në vitin 2021 në listën që e udhëheq Agjencia kishte 1.445 posedues të informacioneve, të ndarë në kategoritë e mëposhtme:

Institucione shtetërore – 146

Komunat dhe Qendrat për zhvillim të rajoneve planore

Personat juridikë dhe fizikë që ushtrojnë kompetenca publike dhe veprimtari me interes publik – 73

Ndërmarrjet dhe institucionet publike – 325;

Institucionet arsimore – 579;

Institucionet shëndetësore -110;

Partitë politike – 57;

Gjyqësori – 67.

Për ilustrim, nga gjithsej 359 ankesa të bazuara në heshtje në vitin 2021, 221 (61.5%) janë parashtruar kundër komunave dhe institucioneve shtetërore.

Tabela 1. Numri i ankesave në bazë të heshtjes sipas kategorive të poseduesve, 2021

Kategoria e poseduesit	Numri i ankesave në bazë të heshtjes
Komunat (me qendra për zhvillim të rajoneve planore)	113
Institucionet shtetërore	108
Personat juridikë dhe fizikë që ushtrojnë veprimtari publike	31
Ndërmarrjet dhe institucionet publike	27
Institucione shëndetësore	24
Pushteti gjyqësor	21
Partitë politike	21
Institucionet arsimore	14

Burimi: AQLI

Nga analiza e Tabelës 1, është e evidente se numri më i madh i ankesave në bazë të heshtjes janë paraqitur vetëm ndaj dy kategorive kryesore të poseduesve të informacionit publik, të cilët përbëjnë një pjesë relativisht të vogël të numrit të përgjithshëm të poseduesve. Nga numri i përgjithshëm i bartësve peshën më të madhe e kanë institucionet

arsimore (579) dhe ndërmarrjet dhe institucionet publike (325), por ato përbëjnë një pjesë shumë të vogël të ankesave të bazuara në heshtje.

Kjo thekson më tej pyetjet për arsyet e heshtjes. Është e qartë se arsyet e heshtjes nga ana e komunave dhe institucioneve shtetërore janë me interes të madh. Për më tepër, është e qartë se këto dy grupe poseduesish përfshijnë institucione mjaft heterogjene, nga komunat e vogla me vetëm 2-3 punonjës deri te ministrinë e mëdha. Është e logjishme të supozohet se arsyet e heshtjes midis të parëve dhe të dytëve nuk janë të njëjta. Ose me fjalë të tjera, disa nga shkaqet e heshtjes do të imponohen me intensitet të ndryshëm tek poseduesit e ndryshëm.

SHËNIM METODOLOGJIK

Analiza bazohet në të ashtuquajturën metodë e përzier, pra një kombinim i të dhënave cilësore dhe sasore. Të dhënat cilësore janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuar me zyrtarë të Agjencisë dhe zyrtarë nga 7 mbajtës. Të dhënat sasore sigurohen nëpërmjet një pyetësoi elektronik të dorëzuar me email tek mbajtësit e informacionit.

Sondazhi është kryer me garanci të plotë të anonimitetit. Asnjë informacion identifikues nuk është kërkuar nga të anketuarit (p.sh. emri i institucionit, emri i të anketuarit, emaili, vendndodhja, etj.). Anonimiteti i plotë zvogëlon rrezikun e autocensurës dhe dhënies së përgjigjeve "të sakta". Por nga ana tjetër eliminon aftësinë e studiuesit për të kryer kontrollin e cilësisë. Kontrolli i cilësisë përbëhet, për shembull, nga vlerësimet se janë përgjigjur në mënyrë serioze, saktë, nga ana e të anketuarit, etj. Në praktikë, bëhet fjalë gjithmonë për një ekuilibër midis garancive të konfidencialitetit dhe/ose anonimitetit dhe mundësisë së kontrollit. Në këtë rast, duke marrë parasysh pozicionin specifik të të anketuarve (persona zyrtarë tek poseduesit), u vendos që të shkohet me anonimitet të plotë pa mundësi kontrolli.


Në përputhje me parimin e pjesëmarrjes vullnetare, anketa nuk përmbante përgjigje të detyrueshme. Të ekzaminuarit patën mundësinë, nëse donin, t'i kalonin të gjitha përgjigjet.

Anketa u është dërguar të gjithë poseduesit, që do të thotë se anketa është realizuar në të gjithë popullsinë. Me fjalë të tjera, ai ishte në formatin e regjistrimit. 575 të anketuar paraqitën përgjigje të vlefshme (Skeda/Grafiku 1 më poshtë). Pyetësoret plotësisht pa përgjigje (e a.q. full non-response) nuk janë përfshirë në llogaritje. Në analizë janë përfshirë pyetësoret e pjesshëm pa përgjigje (e a.q. partial non-response), ku të anketuarit nuk janë përgjigjur në disa pyetje.

Tabela/Grafikoni 1 jep të anketuarit sipas kategorive të mbajtësve. Vihet re se 205 të anketuar janë shprehur se punojnë në një institucion shtetëror, pavarësisht se në listën e Agjencisë janë vetëm 146 institucione shtetërore. Bëhet fjalë për një gabim në interpretimin e saktë të emrit të kategorisë së institucionit për të cilin ata punojnë, tek të anketuarit e caktuar.

Tabela/grafikoni 1. Lloji i poseduesit të informacionit

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Institucioni shtetëror	205	35.7	36.4	36.4
Komuna	41	7.1	7.3	43.7
Personat fizikë dhe juridikë që kryejnë...	28	4.9	5.0	48.7
Ndërmarrje publike dhe institucione	158	27.5	28.1	76.7
Institucione arsimore	63	11.0	11.2	87.9
Institucione shëndetësore	36	6.3	6.4	94.3
Parti politike	13	2.3	2.3	96.6
Pushteti gjyqësorë	19	3.3	3.4	100.0
Gjithsej	563	98.1	100.0	
Pa përgjigje	n/p	11	1.9	
Gjithsej	574	100.0		




QËNDRIME TË ZYRTARËVE PËR TRANSPARENCËN E INSTITUCIONIT TË TYRE

Pyetjet hyrëse në pjesën e anketës së hulumtimit i referohen pikëpamjeve të të anketuarve për transparencën proaktive të institucionit të tyre (Tabela/Grafikoni 2) dhe efektivitetin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik (LQLIKP) (Tab/Grafikoni 3).

Nga Tabela/Grafikoni 2 më poshtë mund të shihet se zyrtarët konsiderojnë se institucionet e tyre janë në masë të madhe transparente në mënyrë proaktive. Koncepti i transparencës proaktive do të thotë që institucioni publikon të dhëna për punën e tij pa mos ia kërkuar dikush paraprakisht, zakonisht duke i publikuar në faqen e tij të internetit..

Tabela/grafikoni 2. Sipas jush, sa është aktiv në transparencë institucioni juaj?

	Numër	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Aspak	2	0.3	0.4	0.4
Nuk është	4	0.7	0.7	1.1
Krejtësisht pak	28	4.9	4.9	6.0
Transparent në mënyrë aktive	336	58.5	59.4	65.4
Shumë transparent në mënyrë aktive	196	34.1	34.6	100.0
Gjithsej	566	98.6	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	5	0.9		
p/p	3	0.5		
Gjithsej	8	1.4		
Gjithsej	574	100.0		



Siç shihet, 59.4% thanë se institucioni i tyre është transparent në mënyrë proaktive dhe 1/3 e zyrtarëve shtesë (34.6%) thanë se institucioni i tyre është transparent në mënyrë shumë proaktive. Vetëm 1.1% thanë se institucioni i tyre nuk është ose nuk është fare transparent.

Një pajtim i tillë i lartë dhe qëndrimi optimist mes zyrtarëve tregon se ka një anshmëri të caktuar (bias) në përgjigjet. Është një dukuri normale në sondazhe, veçanërisht në rastin e pyetjeve që janë shumë “personale”. Në këtë rast, pyetja prek drejtpërdrejt autoritetin e vetë të anketuarit. Megjithatë, këto përgjigje duhet të jenë të balancuara kundrejt përgjigjeve të marra përmes intervistave me palët relevante të interesit, të cilat tregojnë se institucionet nuk janë gjithmonë të gatshme të publikojnë të dhëna për punën e tyre në uebfaqe. Sipas një dëshmie:

“Ata nuk duan të vendosin një organogram të thjeshtë në faqen e internetit. Ata thonë se nuk duan që të gjithë ta dinë se si janë organizuar. Deri atje shkon.”

Konkluzioni është se të dhënat nga Tab/Grafiku 1 duhet të interpretohen me kujdes. Përveç kësaj, e nxisin pyetjen se sa zyrtarët janë të njohur me konceptin e transparencës aktive dhe konceptin e transparencës në përgjithësi. Kjo meriton analizë të mëtejshme.

EFIKASITETI I LQLIKP

Shumica e zyrtarëve konsiderojnë se LQLIKP është efektive (Tabela/grafikoni 3 më poshtë). Vetëm 3.4% thanë se nuk është ose nuk është fare. Nga ana tjetër, rreth 88% thanë se ishte efektive ose shumë efektive. Shkalla e mospërgjigjeve ("nuk e di" ose "pa përgjigje-p/p") është mjaft e ulët.

Konkluzioni është se shumica e zyrtarëve besojnë se ligji i arrin qëllimet e tij, pra është efektiv. Në të njëjtën kohë, si me pyetjen e mëparshme, kjo duhet të merret me një sasi të caktuar anshmërie.

Megjithatë, fakti që ligji është efektiv, mbështetet nga informacione që vijnë nga burime të tjera. Është, për shembull, numri i kërkesave të përgjigjura nga numri i përgjithshëm i kërkesave të parashtruara në institucione. Mbështetja vjen edhe nga intervistat me aktorët relevantë.

Ka indikacione se kërkesa e marrë për QLIKP krijon procese brenda poseduesit. Krijohet një dinamikë ndërmjet zyrtarit që është i obliguar të japë informacionin, departamentit që është i obliguar ta përgatisë atë dhe në disa raste menaxhmentit të poseduesit. Në raste të caktuara, zyrtari duhet të nxisë që të përgatisë informacionin e kërkuar nga sektori kompetent që është i obliguar t'ia japë. Në të njëjtën kohë, justifikimet e zakonshme për mosdorëzimin janë se "email-i nuk ka mbërritur". Nxitja zakonisht përfshin kërkimin e ndihmës nga menaxhmenti i institucionit.


Praktika standarde e personave zyrtarë, kur nuk marrin informacion nga sektori kompetent, është t'i drejtohen udhëheqësish së institucionit:

“Po kërkoj të ndërhyj përmes kryetarit të komunës dhe ashtu ta marr”.

“...kur nuk e marrim, i rikujtojmë se presim përgjigje, gojarisht dhe me email, ndonjëherë edhe ministrin e fusim në email.”

Tabela/grafikoni 3. Sipas jush, sa është efektiv LQLIKP?

	Numri	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Aspak	4	0.7	0.7	0.7
Nuk është	15	2.6	2.7	3.4
Shumë pak	47	8.2	8.5	12.0
Është efektiv	402	70.0	73.0	84.9
Shumë është efektiv	83	14.5	15.1	100.0
Gjithsej	551	96.0	100.0	
Pa përgjigje	Nuk edi	22	3.8	
	p/p	1	0.2	
	Gjithsej	23	4.0	
Gjithsej	574	100.0		



Është e qartë se ligji krijon procese të brendshme negociimi dhe ndonjëherë edhe konfrontime ndërmjet segmenteve të institucionit.

Sipas një pretendimi:

“Jam këtu prej...[një kohë të gjatë]...sa herë bie në konflikt me njerëz që mendojnë se informacioni nuk duhet dhënë. Shumica e kolegëve janë mirë, por ka nga ata që nuk shqetësohen, ndaj duhet t'i kujtosh disa herë dhe indirekt t'u bësh presion për të kryer punën.”

Këto procese nisen nga kërkesa e paraqitur. Kjo në fakt është një dëshmi shtesë se ligji ka ndikim në sjelljen e institucioneve, pra që ligji është efektiv.

TRAJNIMI I ZYRTARËVE

Zyrtarët në përgjithësi mendojnë se janë të trajnuar për detyrat që kanë në lidhje me QLIK. Në të njëjtën kohë, 8.3% thanë se nuk janë të trajnuar ose nuk janë aspak të trajnuar, 19.7% thanë se janë të trajnuar pak, pjesa tjetër thanë se janë të trajnuar (56.7%) ose plotësisht të trajnuar (15.2%). Shkalla e mospërgjigjeve (nuk e di ose n/p) është e ulët.

Tabela 4. A mendoni se jeni mjaftueshëm të trajnuar për punën si zyrtar?

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Jo aspak	13	2.3	2.3	2.3
Nuk jam i/e trajnuar	34	5.9	6.0	8.3
Shumë pak	111	19.3	19.7	28.0
Jam i/e trajnuar	320	55.7	56.7	84.8
Jam i/e trajnuar plotësisht	86	15.0	15.2	100.0
Gjithsej	564	98.3	100.0	
Pa përgjigje	Nuk e di	8	1.4	
	p/p	2	0.3	
	Gjithsej	10	1.7	
Gjithsej	574	100.0		


Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të bëhen vërejtjet e mëposhtme. Në disa nga intervistat, disa persona zyrtarë treguan nevojën për trajnim. Mirëpo, nga ana tjetër, Agjencia në raportet e saj vjetore publikon të dhëna se një pjesë e madhe e institucioneve nuk u përgjigjen ftesave për trajnim.

Për shembull, në raportin vjetor për vitin 2021, Agjencia raporton se nga gjithsej 597 institucione të ftuara, 237 janë përgjigjur ndërsa 335 nuk janë përgjigjur.¹

Për më tepër, intervistat me zyrtarët e Agjencisë tregojnë se Agjencia punon rregullisht me poseduesit, përkatësisht i mentoron rregullisht, i ndihmon në zgjidhjen e detyrave specifike. Kjo është një pjesë integrale e procesit të edukimit/trajnit të institucionit.

¹ fq. 27-29

Grafikoni 4. A mendoni se jeni mjaftueshëm të trajnuar për punën si person zyrtar??



NJOHJA E DREJTUESVE ME LQLIKP


Njohja e LQLIKP-së nga ana e drejtuesve të poseduesi është e një rëndësie të veçantë, sepse kërret e sektorëve/departamenteve realisht u përgjigjen kërkesave për LQLIKP-në. Personi zyrtar vetëm ndërmjetëson.

Personat zyrtarë përgjithësisht besojnë se menaxherët e njohin LQLIKP-në (tabela/grafikoni 5): 53.2% iu përgjigjen pozitivisht kësaj pyetjeje, dhe 14.1% të tjerë thanë se menaxherët janë plotësisht të njohur. Megjithatë, ka qëndrime që janë shpërndarë në anën e majtë të shkallës: 8.7% thanë se drejtuesit nuk janë ose nuk janë fare të njoftuar me ligjin; 24.1% thanë se janë shumë pak të njoftuar. Pra në përgjithësi, pothuajse 1/3 e zyrtarëve mendojnë se menaxherët kanë nevojë për njohuri shtesë të ligjit.

Disa indikacione shtesë të nxjerra nga pjesa cilësore e hulumtimit (intervistat) tregojnë se zbatimi i mirë varet nga niveli i trajnimit dhe njohjes së ligjit.

Tab/grafiku 5. Sa mendoni se drejtuesit në institucionin tuaj janë të njohur me ligjin?

	Numri	përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Nuk janë aspak	21	3.7	3.8	3.8
Nuk janë të njohur	27	4.7	4.9	8.7
Shumë pak	133	23.2	24.1	32.7
Janë të njohur	294	51.2	53.2	85.9
Janë plotësisht të njohur	78	13.6	14.1	100.0
Gjithsej	553	96.3	100.0	
Ps përgjigje				
Nuk e di	20	3.5		
p/p	1	0.2		
Gjithsej	21	3.7		
Gjithsej	574	100.0		




NJOHJA ME PARIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS

Personat zyrtarë në përgjithësi besojnë se drejtuesit në institucionin e tyre e njohin parimin e delegimit të kompetencës: 56.2% thanë se drejtuesit janë të vetëdijshëm dhe 13.9% të tjerë se janë plotësisht të vetëdijshëm. Megjithatë, pothuajse 1/3 e personave zyrtarë besojnë se njohja është shumë e vogël, mungon ose mungon fare.

Tabela/grafikon 6. Sa mendoni se drejtuesit në institucionin tuaj janë të njohur me parimin e delegimit të kompetencës?

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Nuk janë aspak	16	2.8	3.0	3.0
Nuk janë të njohur	34	5.9	6.3	9.2
Shumë pak	112	19.5	20.7	29.9
Janë të njohur	304	53.0	56.2	86.1
Plotësisht janë të njohur	75	13.1	13.9	100.0
Gjithsej	541	94.3	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	28	4.9		
p/p	5	0.9		
Gjithsej	33	5.7		
Gjithsej	574	100.0		

Sa mendoni se drejtuesit në institucionin tuaj janë të njohur me parimin e delegimit të kompetencës?




BASHKËPUNIMI I ZYRTARIT ME SEKTORËT KOMPETENT

Siç u përmend më sipër, personi zyrtar ndërmjetëson ndërmjet kërkuesit dhe poseduesit. Informacioni përgatitet nga sektori ose departamenti kompetent i poseduesit. Personi zyrtar e përcjell kërkesën deri tek ata dhe më pas ia përcjell përgjigjen kërkuesit. Në këtë kuptim, është e nevojshme të ketë komunikim dhe bashkëpunim ndërmjet personit zyrtar dhe sektorëve kompetentë.

Tabela/grafikoni 6. Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi i personit zyrtar me sektorët që duhet të japin informacionin, në institucionin tuaj?

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Nuk është aspak	7	1.2	1.2	1.2
Nuk është e kënaqshme	17	3.0	3.0	4.3
Shumë pak	33	5.7	5.9	10.1
E kënaqshme	331	57.7	58.9	69.0
Shumë e kënaqshme	174	30.3	31.0	100.0
Gjithsej	562	97.9	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	7	1.2		
p/p	5	0.9		
Gjithsej	12	2.1		
Gjithsej	574	100.0		

Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi i personit zyrtar me sektorët që duhet të japin informacionin në institucionin tuaj?



- Nuk janë aspak
- Nuk janë të njohur
- Shumë pak
- Janë të njohur
- Jane e plotësisht të njohur


Qëndrimi i personave zyrtarë është se ky bashkëpunim është i kënaqshëm (58.9%) ose shumë i kënaqshëm (31%). Një pjesë shumë e vogël thanë se bashkëpunimi kënaq pak (5.9%), nuk kënaq (3%) ose nuk kënaq fare (1.2%). Në të njëjtën kohë, shkalla e mospërgjigjeve ("Nuk e di" ose "p/p") është shumë e ulët.

PERSON ZYRTAR I PËRBASHKËT PËR DY OSE MË SHUMË INSTITUCIONE

Ekzistojnë posedues që janë shumë të vegjël dhe kanë për shembull vetëm 2-3 punonjës. Me posedues të tillë, detyrimet shtesë që dalin nga ligji për personin zyrtar mund të paraqesin barrë si për personin zyrtar ashtu edhe për poseduesin. Ligji parashikon mundësinë që disa posedues të ndajnë një person zyrtar posaçërisht për atë arsye, në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti në zbatimin e ligjit.

Tabela/grafikoni 7. A mendoni se do të përmirësohet efikasiteti i punës nëse një person zyrtar caktohet në dy ose më shumë institucione??

	Numër	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Aspak jo	84	14.6	18.2	18.2
Nuk do të përmirësohet	193	33.6	41.8	60.0
Shumë pak	56	9.8	12.1	72.1
Do të përmirësohet	106	18.5	22.9	95.0
Shumë do të përmirësohet	23	4.0	5.0	100.0
Gjithsej	462	80.5	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	104	18.1		
p/p	8	1.4		
Gjithsej	112	19.5		
Gjithsej	574	100.0		



Qëndrimi i zyrtarëve për këtë çështje është se emërimi i një zyrtari të përbashkët nuk do të përmirësojë shumë efikasitetin. Vetëm 22.9% thanë se do të përmirësohej dhe një shtesë prej 5% thanë se do të përmirësohej shumë. Shumica thanë se do të përmirësohej shumë pak (12.1%) ose jo (41.8%) ose aspak (18.2%).

Në interpretimin e këtyre përgjigjeve duhet të merret parasysh anshmëria e të anketuarve sepse pyetja i prek drejtpërdrejt ata..


ARSYET PËR HESHTJE

LLOJI I KËRKESËS

Në pjesën tjetër, analiza trajton disa çështje që lidhen me arsyet e heshtjes së institucioneve, pra rastet kur poseduesi nuk i përgjigjet një kërkesë për QLIK. Interesi kryesor i analizës është të zbulojë pse, pra cilat janë arsyet e heshtjes.

Tabela/grafikoni 8. Lloji i kërkesës (shumë i ndjeshëm)

	Numër	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Nuk është aspak	74	12.9	16.9	16.9
Nuk është	67	11.7	15.3	32.3
Shumë pak	103	17.9	23.6	55.8
Është arsyeja për heshtje	121	21.1	27.7	83.5
Është arsyeja kryesore	72	12.5	16.5	100.0
Gjithsej	437	76.1	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	51	8.9		
p/p	86	15.0		
Gjithsej	137	23.9		
Gjithsej	574	100.0		



Arsyeja e parë e mundshme për të cilën personat zyrtarë duhet të marrin një vendim është lloji i kërkesës, domethënë ndjeshmëria e saj. Interesi është të zbulohet se deri në çfarë mase kjo shkakohet nga mosdhënies së përgjigjes.

Në përgjithësi, qëndrimi është prirja se lloji i kërkesës është arsye për heshtje. Siç shihet nga grafikoni, përgjigjet janë më shumë në anën e djathtë të shkallës: 23.6% thanë se është shumë pak arsye për heshtje, 27.7% se është arsye për heshtje dhe 16.5% se është një arsye kryesore. Rreth 1/3 mendojnë se nuk është (15.3%) ose aspak (16.9%) arsye për heshtje. Në të njëjtën kohë, përqindja e mospërgjigjeve është domethënëse (23.9%), gjë që tregon se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (1/4) i janë shmangur përgjigjes.

Informacione shtesë dalin përmes të dhënave cilësore. Sipas një bashkëbiseduesi:

“Varet nga lloji i kërkesës dhe qëndrimi i përgjithshëm i institucionit. Por më së shumti është kur ka kërkesa për financa. Prokurimi publik, nga ana e organizimit, mënyra e funksionimit. Këtu ata ngrenë frenën.”

VËLLIMI I TË DHËNAVE

Ka indikacione të qarta se në raste të caktuara kërkesat për QLIKIP janë të rëndësishme për nga shtrirja, pra kërkohen shumë informacione të cilat shpesh kërkojnë punë të konsiderueshme për t'u përgatitur.

Sipas disa bashkëbiseduesve:

“Ka raste që, për shembull, partia ka kërkuar informacion shumë të gjerë, sa automjete ka komuna dhe sa karburant është konsumuar në periudhën 2007-2021. Pra kjo është një periudhë shumë e gjatë, e kuptoj nëse kërkohet për një muaj ose një vit ose dy.”

Të anketuarit kanë paraqitur kërkesa të tjera të ngjashme: p.sh. informacion për të gjithë personat që janë punësuar me kontratë pune, për sa kohë dhe sa janë paguar, për 10 vitet e fundit.


Natyrisht, përgatitja e një përgjigjeje ndaj kësaj kërkesë kërkon shumë punë. Bashkëbiseduesit theksojnë se përgjigjja e një kërkesë të tillë mund të nënkuptojë që i gjithë sektori të lërë gjithçka tjetër dhe t'i kushtojë disa ditë ekskluzivisht kësaj kërkesë.

Personat zyrtarë në përgjithësi besojnë se sasia e të dhënave të kërkuara është një arsye për heshtje: 25.8% thanë se ishte shumë pak, 25.8% të tjerë thanë se ishte një arsye për heshtje dhe 13.5% shtesë thanë se ishte arsyeja kryesore për heshtje. Në anën e majtë të shkallës, 17.2% thanë se nuk ishte fare arsye dhe 17.7 të tjerë se nuk ishte arsye për heshtje.

Duhet theksuar se shkalla e mospërgjigjeve në këtë pyetje është gjithashtu domethënëse dhe arrin në 21.1% (6.1% thanë se nuk e dinë, ndërsa 15% nuk dhanë përgjigje).

Tabela/Grafikoni 9. Vëllimi i të dhënave të kërkuara

	Numër	Përqindje	Përqindja e vlefshme	Përqindja komulative
Aspak nuk është	78	13.6	17.2	17.2
Nuk është	80	13.9	17.7	34.9
Shumë pak	117	20.4	25.8	60.7
Është arsye për heshtje	117	20.4	25.8	86.5
Është arsyeja kryesore për heshtje	61	10.6	13.5	100.0
Gjithsej	453	78.9	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	35	6.1		
p/p	86	15.0		
Gjithsej	121	21.1		
Gjithsej	574	100.0		




MOSAZHURITETI I DREJTUESVE

Është e qartë se dhënia e informacionit varet nga sektorët e poseduesit dhe drejtuesit e tyre. Ata përgatisin informacionin. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të vlerësohet nëse mbingarkesa e informacionit është rezultat i dobësisë ose, për shembull, i një qëndrimi që informacioni nuk duhet dhënë. Rasti i dytë është një tregues i qartë i pranisë së mbylljes institucionale dhe kulturës jodemokratike, pra situatave për të kapërcyer të cilat ligji është miratuar. Rasti i parë (mosazhuritet) tregon joefikasitet, por vetë më vete nuk çon në praninë e vlerave jodemokratike.

Qëndrimi i personave zyrtarë është se në përgjithësi mosazhuriteti është në një masë më të vogël arsye për heshtje. Grafikoni 10 tregon se përgjigjet janë të përqendruara në anën e majtë të shkallës: 19% thanë se mungesa e përpikmërisë nuk është aspak arsye për heshtje, 23.3% se nuk është dhe 27.1% se është pak. Domethënë, gjithsej 69.5% konsiderojnë se arsyeja është ose jo ose fare pak mungesa e azhuritetit. Nga ana tjetër, rreth 1/3 e personave zyrtarë mendojnë se mungesa e azhuritetit është arsyeja kryesore e heshtjes.

Tabela/grafikoni 10. Mosazhureteti i drejtuesve

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Aspak nuk është	84	14.6	19.0	19.0
Nuk është	103	17.9	23.3	42.3
Shumë pak	120	20.9	27.1	69.5
Arsyeja për heshtje	91	15.9	20.6	90.0
Është arsyeja kryesore për	44	7.7	10.0	100.0
Gjithsej	442	77.0	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	24	4.2		
p/p	108	18.8		
Gjithsej	132	23.0		
Gjithsej	574	100.0		




TEPËR OBLIGIME TË PERSONAVE ZYRTARË

Nga ana tjetër, personat zyrtarë janë të prirur të konfirmojnë se mbingarkesa e tyre me përgjegjësi është një arsye e rëndësishme për heshtje. Analiza e përgjigjeve duhet të marrë parasysh sigurisht momentin e anshmërisë. Përgjigjet janë në anën e djathtë të shkallës: 26.3% mendojnë se është shumë pak, 23.9% se është arsye për heshtje dhe 17% shtesë se është arsyeja kryesore e heshtjes. Në anën e majtë, rreth 1/3 e personave zyrtarë besojnë se nuk është ose nuk është fare arsye për heshtje.

Tabela/grafikoni 11. Shumë obligime të zyrtarëve

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Aspak nuk është	72	12.5	15.5	15.5
Nuk është	80	13.9	17.2	32.8
Shumë pak	122	21.3	26.3	59.1
Është arsye për heshtje	111	19.3	23.9	83.0
Është arsyeja kryesore për heshtje	79	13.8	17.0	100.0
Gjithsej	464	80.8	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	17	3.0		
p/p	93	16.2		
Gjithsej	110	19.2		
Gjithsej	574	100.0		




TEPËR OBLIGIME TË SEKTORËVE KOMPETENTË

Pak më shumë se 1/3 e zyrtarëve mendojnë se arsyeja e heshtjes është se sektorët kompetentë kanë shumë obligime; 27.4% thanë se ishte arsyeja e heshtjes dhe 10.8% thanë se ishte arsyeja kryesore e heshtjes. Megjithatë, shumica konsiderojnë se është shumë pak, nuk është ose nuk është aspak arsye për heshtje.

Natyrisht, krahasimi mes pyetjes së mëparshme (obligimet e personave zyrtarë) dhe kësaj pyetjeje është interesant. Përkundër faktit që personat zyrtarë konfirmojnë se vetëm ndërmjetësojnë në dhënien e informacionit dhe se puna kryesore është tek sektorët kompetentë, ata ende janë të prirur të besojnë se zënia e tyre (e zyrtarëve) është arsya më e rëndësishme për heshtje.

Tabela/grafikoni 12. Tepër obligime të sektorëve kompetentë

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Apsak nuk është	69	12.0	15.2	15.2
Nuk është	90	15.7	19.9	35.1
Shumë pak	121	21.1	26.7	61.8
Është arsye për heshtje	124	21.6	27.4	89.2
Është arsyeja kryesore për heshtje	49	8.5	10.8	100.0
Gjithsej	453	78.9	100.0	
Nuk ka përgjigje	Nuk e di	16	2.8	
	p/p	105	18.3	
	Gjithsej	121	21.1	
Gjithsej	574	100.0		



QËNDRIMI I UDHËHEQËSISË PËR TË MOS DHËNË INFORMACION


Shumica e personave zyrtarë mendojnë se mosdhënia e informacionit nuk është rezultat i asaj se udhëheqësia ka vendosur të mos jepet informacion: mbi ¼ kanë thënë se kjo nuk është fare arsye për heshtje, edhe ¼ kanë thënë se nuk është arsye, dhe 16.4% të tjerë kanë thënë se krejtësisht pak është arsye për heshtje. Në anën e djathtë të shkallës, 19.6% kanë thënë se është shkak, dhe 11.2% kanë thënë se është shkak kryesor për heshtje. Me këtë rast, shkalla e mos përgjigjes është e lartë dhe janë 25,4%, që thonë se ¼ e të anketuarve kanë eskivuar përgjigjen në pyetje.

Është e rëndësishme të theksohet se sipas informacioneve të marra nga intervistat, pengimi i dhënies së informacionit në raste të caktuara vjen drejtpërdrejt nga drejtuesit. Në disa raste, kjo shkakton një ndjenjë frike dhe stresi tek personat zyrtarë. Kjo e dhënë është një konfirmim shtesë e qëndrimit të 11.2% të zyrtarëve se qëndrimi i udhëheqësisë është arsyeja kryesore e heshtjes.

Tabela/grafikoni 13. Qëndrimi i udhëheqësisë për të mos dhënë informacion

	Numri	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Aspak nuk është	112	19.5	26.2	26.2
Nuk është	114	19.9	26.6	52.8
Shumë pak	70	12.2	16.4	69.2
Është arsyeja për heshtje	84	14.6	19.6	88.8
Është arsyeja kryesore për heshtje	48	8.4	11.2	100.0
Gjithsej	428	74.6	100.0	

Nuk ka përgjigje	Nuk e di	33	5.7		
	p/p	113	19.7		
	Gjithsej	146	25.4		
Gjithsej		574	100.0		




PAMUNDËSIA PËR TU PËRGJIGJUR BRENDA AFATIT

Sipas shumicës së personave zyrtarë, afati nuk është një arsye e rëndësishme për heshtje: 20.9% thanë se ishte arsye, dhe 10.7% të tjerë thanë se ishte arsyeja kryesore e heshtjes. Pjesa tjetër e personave zyrtarë konsiderojnë se është tejte pak, nuk është arsye, ose aspak nuk është arsye për heshtje.

Konkluzioni është se afati brenda të cilit duhet të dorëzohet përgjigja nuk është një arsye e rëndësishme për heshtje.

Tabela/grafikoni 14. Pamundësia për tu përgjigjur brenda afatit

	Numri	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Aspak nuk është	74	12.9	16.1	16.1
Nuk është	106	18.5	23.1	39.2
Shumë pak	134	23.3	29.2	68.4
Është arsye për heshtje	96	16.7	20.9	89.3
Është arsye për heshtje	49	8.5	10.7	100.0
Gjithsej	459	80.0	100.0	
Nuk ka përgjigje	Nuk e di	14	2.4	
	p/p	101	17.6	
	Gjithsej	115	20.0	
Gjithsej	574	100.0		




MUNGESA E TRAJNIMEVE

E fundit në vargun e pyetjeve për arsyet e heshtjes ka të bëjë me mungesën e trajnimit. Siç mund të shihet nga Tab/graf. 15, një pjesë e konsiderueshme e personave zyrtarë konsiderojnë se arsyeja është mungesa e trajnimit: 26.8% e konsiderojnë këtë si arsye dhe 14% të tjerë e konsiderojnë si arsyen kryesore të heshtjes.

Pra, pak më shumë se 40% e të anketuarve e konsiderojnë atë si arsyen apo arsyen kryesore të heshtjes.

Tabela/grafikoni 15. Mungesa e trajnimit

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Aspak nuk është	76	13.2	16.1	16.1
Nuk është	83	14.5	17.6	33.8
Shumë pak	120	20.9	25.5	59.2
Është arsye për heshtje	126	22.0	26.8	86.0
Është arsyeja kryesore për heshtje	66	11.5	14.0	100.0
Gjithsej	471	82.1	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	11	1.9		
p/p	92	16.0		
Gjithsej	103	17.9		
Gjithsej	574	100.0		




Tabela/grafikoni 16 më poshtë tregon notat mesatare (në shkallën 1-5) për secilën nga arsyet e përfshira të heshtjes.

Siç mund të shihet, sipas personave zyrtarë, arsyeja më e rëndësishme (3.11) është lloji i kërkesës, respektivisht ndjeshmëria e saj.

Në fund të renditjes qëndron mungesa e azhuritetit të udhëheqësve apo qëndrimi i tyre i përgjithshëm për të mos dhënë informacion.

Tab/grafik. 16. Arsyet kryesore dhe heshtja, mesatarja

	Mesatarja
Lloji i kërkesës (shumë i ndjeshëm)	3.11
Shumë obligime të personave zyrtarë	3.10
Mungesa e trajnimit	3.05
Sasia e të dhënave të kërkuara	3.01
Shumë obligime të sektorëve kompetentë	2.99
Mospërgjigje brenda afatit	2.87
Mungesa e përpikmërisë së udhëheqësve	2.79
Qëndrimi i udhëheqësisë për të mos dhënë informacion	2.63



PRAPAVIJA E KËRKESAVE POLITIKE

Bisedat me palët e interesuara treguan mundësinë që disa nga kërkesat të ishin të motivuara politikisht. Kjo e dhënë u kontrollua më pas përmes anketës dhe u verifikua. Ka indikacione reale se kërkesat për QLIKIP janë parashtruar për motive politike. Pothuajse 1/5 e personave zyrtarë (18.8%) thanë se shumë prej kërkesave kanë prapavijë politike; 6.9% të tjerë thanë se shumica e kërkesave ishin të tilla. Megjithatë, përveç kësaj, ¼ e zyrtarëve (24.1%) kanë konfirmuar se kjo është e vërtetë për një pjesë shumë të vogël të kërkesave. Nga ana tjetër, rreth ½ e personave zyrtarë thanë se kërkesat kanë pak ose aspak prapavijë politike.

Tabela/grafikoni 17. Sa prej kërkesave konsideroni se kanë sfond politik?

	Numri	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Nuk kanë aspak	97	16.9	20.9	20.9
Nuk kanë	136	23.7	29.3	50.2
Një pjesë mjaft e vogël e kërkesave	112	19.5	24.1	74.4
Shumë prej kërkesave	87	15.2	18.8	93.1
Pjesa më e madhe e kërkesave	32	5.6	6.9	100.0
Gjithsej	464	80.8	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	102	17.8		
p/p	8	1.4		
Gjithsej	110	19.2		
Gjithsej	574	100.0		




SHFRYTËZIMI I PAARSYESHËM I LIGJIT

Nga intervistat me aktorët si dhe nga anketa e kryer ka indikacione relevante se në praktikë ka shembuj të shfrytëzimit të paarsyeshëm të ligjit. Kërkimi i të dhënave tepër të gjera për një periudhë të gjatë kohore, ose "bombardimi" i një institucioni me qindra kërkesa mund të konsiderohen si shembuj të tillë kërkesash të paarsyeshme. Sigurisht, vendosja e një kufiri specifik përtej të cilit një shfrytëzim i caktuar i ligjit do të konsiderohej i paarsyeshëm, duhet të jetë çështje debati dhe vlerësimi të kujdesshëm.

Personat zyrtarë besojnë se ka një përdorim të paarsyeshëm të ligjit në një masë të caktuar (Tabela/Grafikoni 17). Në veçanti, pothuajse ¼ e zyrtarëve (24.6%) mendojnë se parashtruesit e kërkesave e shfrytëzojnë atë në mënyrë të paarsyeshme, ndërsa 6.8% të tjerë mendojnë se ka përdorim shumë të paarsyeshëm. Shumica është në mes të shkallës; 42% konsiderojnë se parashtruesit e shfrytëzojnë ligjin deri diku në mënyrë të paarsyeshme. Konkluzioni është se kjo praktikë është e pranishme. Disa nga shembujt që janë paraqitur më herët në tekst, janë një ilustrim plotësues për këtë.

Tabela/grafikoni 18. Deri në çfarë mase mendoni se parashtruesit e shfrytëzojnë ligjin në mënyrë të paarsyeshme

	Numri	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Aspak jo	54	9.4	11.1	11.1
Nuk e përdorin në mënyrë të paarsyeshme	76	13.2	15.6	26.6
Shumë pak	205	35.7	42.0	68.6
E përdorin në mënyrë të paarsyeshme	120	20.9	24.6	93.2
E përdorin shumë në mënyrë të paarsyeshme	33	5.7	6.8	100.0
Gjithsej	488	85.0	100.0	
Pa përgjigje				
Nuk e di	83	14.5		
p/p	3	0.5		
Gjithsej	86	15.0		
Gjithsej	574	100.0		



PËRGJEGJËSIA PËR MOSZBATIMIN E LQLIKP-SË

Është evident qëndrimi se dispozitat për mbajtjen e përgjegjësisë për mosdhënie të informacionit duhet të ndryshohen. Zgjidhja e mëparshme ligjore parashikonte përgjegjësi penale për personin udhëheqës. Ligji i ri parashikon përgjegjësi kundërvajtëse vetëm për zyrtarin e emëruar. Ka prova të qarta që një pjesë e madhe e aktorëve nuk pajtohen me këtë model. Në të njëjtën kohë, ka dëshmi se kjo zgjidhje ligjore do të ulë efektivitetin e ligjit në një periudhë afatmesme.

Sipas një personi zyrtar:

“Të gjitha sanksionet kanë të bëjnë me personin e autorizuar. Nëse nuk mund të marrë një përgjigje edhe pas disa urgjencave, nuk e di se çfarë mund të bëj tjetër. Ajo pjesë e ligjit duhet të ndryshohet dhe përgjegjësi duhet të mbajë ai që nuk e jep informacionin”.

Ky qëndrim konfirmohet nga disa aktorë të përfshirë në proces. Kjo shpie deri në përfundimin e qartë se dispozitat ndëshkuese janë në vijën e uljes së efektivitetit të ligjit sepse mundësojnë një amnisti të lehtë nga përgjegjësia për aktorët që në fakt vendosin të mos japin informacionin e kërkuar. Përgjegjësia bie mbi personin zyrtar që ndërmjetëson vetëm ndërmjet aplikuesit dhe poseduesit.

Sipas një pikëpamjeje të ngjashme:

“... këtu përpiluesi i ligjit nuk e ka parashikuar mirë. Nuk mundet që meqë unë firmos, të mbaj përgjegjësi. Unë jam vetëm një ndërmjetës, megjithëse nënshkruaj. Marr një kërkesë dhe njoftoj sektorin që duhet të përgjigjet. Nëse nuk marr përgjigje prej tyre, ose më thotë shefi (në këtë rast kryetari i komunës) që nuk guxon të jepen të dhëna të tilla, kush duhet të mbajë përgjegjësi këtu, unë, shefi apo udhëheqësi i sektorit. Mund të percjell vetem se duhet dhënë një përgjigje, nese nuk ma japin, s'kam çfarë të bëj, nuk më takon mua.”

Ngjashëm:

“...Nuk më pëlqen që na detyrojnë direkt si persona zyrtarë. Pse duhet të përfshihemi? Nuk mund të garantoj se do të më japin përgjigje në çdo sektor. Unë mund të percjell vetëm kërkesat, për disa gjëra edhe kryetari i komunës duhet të më japë leje për t'i dhënë ato të dhëna. Pse duhet të jem përgjegjës nëse nuk më kanë dhënë miratimin? Nuk varet gjithmonë nga ne, personat zyrtarë”.

Gjithashtu:

[Duhet] “të ketë një riformulim për vendimet ndëshkuese që në shënjestër të mos jetë personi zyrtar, por personi përgjegjës – kryetari i komunës, drejtori, shefi i sektorit etj. Ligji duhet të ndryshohet”. ose:

“Dispozitat kundërvajtëse janë të gjitha kundër punonjësit. Unë personalisht nuk jam dakord me atë normë... Ata vetëm ndërmjetësojnë, aq është autorizimi i tyre. Ka heshtje nga eprorët e tyre. Ata janë lënë të vetëm.”

LQLIKP SI ZËVENDËSIM PËR NJË RREGULLORE TJETËR

Ka disa indikacione se ligji po shfrytëzohet nga disa aplikues të cilët nuk kanë arritur të marrin informacionin për arsye të tjera. Kjo mund të shihet nga lloji i mëposhtëm i pohimit:

“Ka edhe persona fizikë që janë prekur por nuk kanë arritur ta sigurojnë dokumentin nëpërmjet një institucioni tjetër. Këto janë më së shumti informacione që personi fizik i kërkon dhe nuk mund t’i marrë nga kadastra, ndaj shfrytëzojnë transparencën e institucioneve për ta marrë”.

Ky argument konfirmohet nga shumë të anketuar të pavarur, kështu që është i vlefshëm. Theksohet se, për shembull, avokatët përdorin ligjin për të marrë informacione që u nevojiten në proceset gjyqësore dhe të cilat mund t’i kërkojnë në kuadër të atij procesi. Megjithatë, ata shkojnë sipas LQLIKP-së, me shumë mundësi sepse kështu do t’i marrin më shpejt dhe më lehtë.

Mund të shihet sërish si provë e efektivitetit të ligjit. Megjithatë, sipas disa pikëpamjeve, ligji nuk duhet të jetë një mekanizëm përmes të cilit do të anashkalohen procedurat për marrjen e informacionit të përcaktuara me ligje të tjera.

KONKLUZION

Me interes të veçantë për këtë analizë të shkurtër ishin arsyet e heshtjes së institucioneve ndaj kërkesave për QLIK. Heshtja është një bazë e rëndësishme për ankesat e paraqitura në Agjenci.

Konkluzioni është se ekziston një kombinim i arsyeve të mundshme për heshtjen e institucionit, të cilat përfshijnë llojin e kërkesës, sasinë e informacionit të kërkuar, aftësinë e sektorëve dhe personave zyrtarë kompetentë për t’iu përgjigjur brenda afatit, si dhe mungesën e azhuritit të udhëheqësisë dhe qëndrimin e tyre se informacione të caktuara nuk duhet të jepen.

Në përgjithësi, sa më i ndjeshëm të jetë informacioni i kërkuar, aq më shumë ka gjasa që poseduesi të hezitojë ta japë atë. Institucionet përgjithësisht janë më të rezervuara për të ofruar informacione lidhur me financat, shpenzimet, taksat, prokurimet, etj.

Një pjesë e vërtetë e arsyeve të heshtjes është për shkak të mungesës së azhuritit. Natyrisht është e qartë se nuk është e lehtë për poseduesit t’u përgjigjen kërkesave për informacion që kërkojnë shumë punë për t’iu përgjigjur.

Poseduesit në fakt respektojnë ligjin dhe shumica e tyre e marrin përgjegjësinë e tyre për t’u përgjigjur seriozisht.

Ka prova reale që ligji është efektiv dhe ka një ndikim real në ndërtimin e një kulture të transparencës institucionale, duke kontribuar kështu në uljen e korrupsionit dhe zhvillimin e vlerave demokratike.